



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 53

Tiranë – E premte, 2 prill 2021

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 195, datë 31.3.2021	5385
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 196, datë 31.3.2021	5385
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 211, datë 31.3.2021	5388
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 213, datë 31.3.2021	5389
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 215, datë 31.3.2021	5390
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 6, datë 31.3.2021	5390
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 7, datë 31.3.2021	5391
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 191, datë 29.3.2021	5399

Kërkesë e Ministrisë së  
Infrastrukturës dhe Energjisë  
nr. 50/3, datë 31.3.2021

Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë  
private, që preken nga projekti “Ndërtim rruga Porto-Romano – Durrës,  
loti 3”.....

5400



## VENDIM

Nr. 195, datë 31.3.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË VENDIMIN NR. 608, DATË 29.7.2020,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
PROCEDURAT, KRITERET DHE  
RREGULLAT PËR ZBATIMIN E  
PROGRAMIT TË NXITJES SË  
PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT  
TË PERSONAVE TË DALË TË PAPUNË  
SI PASOJË E COVID-19”,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 608, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, të kreut I, fjalët “... 23 qershor 2020.” zëvendësohen me “... 31 dhjetor 2020.”.

2. Në pikën 4, të kreut II, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) në shkronjën “a”, fjalët “... shoqëri tregtare të regjistruara;” zëvendësohen me “... persona fizikë apo juridikë të regjistruar;”;

b) në shkronjën “dh”, fjalët “... shoqëri tregtare ...” zëvendësohen me “... persona fizikë apo juridikë ...”.

3. Në pikën 1, të kreut V, para fjalëve “Institucioni përgjegjës ...” shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Afat i zbatimit të kësaj skeme është deri më 31 dhjetor 2021.”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe

## VENDIM

Nr. 196, datë 31.3.2021

**PËR INDEKSIMIN E PENSIONEVE  
DHE BAZËS SË VLERËSUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 59, 61 e 88, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, të nenit 24, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të nenit 6/1, të ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të nenit 1, të ligjit nr. 8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare në pension”, të nenit 8, të ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve



të industrisë së naftës dhe të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 137/2021, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Indeksimin, në masën 2.7 për qind, të:

a) pensioneve të caktuara sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) pensioneve sociale, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar me vendimin nr. 326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr. 758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”;

d) shtesës mbi pension, të dhënë sipas nenit 33, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

dh) shtesave mbi pension, të dhëna sipas neneve 38, 39 e 48, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 24, të ligjit nr. 4171, datë 13.6.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

e) pensioneve të caktuara dhe të rillogaritura me ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21, të këtij ligji;

ë) trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara sipas ligjeve nr. 8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, dhe nr. 9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar;

f) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare në pension”;

g) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve të minierave, të caktuara sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar;

gj) pensioneve të pleqërisë të punonjësve të minierave, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

h) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

i) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”;

j) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;

k) shpërblimit të caktuar sipas ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të ndryshuar;

l) pensioneve shtetërore të posaçme të caktuara në përputhje me nenin nr. 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

ll) përfitimeve të caktuara sipas ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë,



të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”;

m) trajtimeve të veçanta financiare sipas neneve 5/1/a dhe 5/1/b të ligjit 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Indeksimin, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, përfshirë edhe këtë datë.

3. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të këtij ligji, si dhe pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, që kanë datë fillimi të së drejtës deri më 31.12.2014, pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk do të jenë më pak se 14 449 (katërmëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e nëntë) lekë në muaj dhe më shumë se 28 898 (njëzet e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë në muaj.

4. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.12.2014, pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi nuk do të jenë më pak se 9 895 (nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë në muaj, por jo më shumë se 14 449 (katërmëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e nëntë) lekë në muaj.

5. Pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, me datë fillimi nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, nuk do të jenë më pak se 14 449 (katërmëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e nëntë) lekë në muaj.

6. Përfituesit e pensioneve, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të

kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, si dhe nr. 150/2014, të caktuara me datë të fillimit të pensionit deri më 31.12.2014, përfshi edhe këtë datë, përveç pensionit të indeksuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, do të vazhdojnë të përfitojnë edhe kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”, nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 17, datë 20.1.2007, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”, në atë masë që i kanë përfituar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, do t'i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione të parakohshme sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, me datë fillimi nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 16 099 (gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e nëntë) lekë në muaj.

8. Përfituesit e pensioneve, sipas pikës 1, shkronjat “a”, “e”, “g”, të këtij vendimi, me datë fillimi të pensionit deri në 31.12.2014 dhe përfituesit e pensioneve të parakohshme sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, krahas pensionit dhe kompensimeve, sipas përcaktimeve në pikat 6 dhe 7, të këtij vendimi, do të marrin edhe kompensimet sipas masës dhe kriterëve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”.



9. Përfituesit e pensionit familjar, përveç pensionit të caktuar sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, do të marrin edhe kompensimet për të ardhurat dhe për ndryshimin e çmimeve, sipas kritereve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”, nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, nr. 138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, dhe udhëzimeve në zbatim të tij, me kusht që pensioni që kishte apo i takonte mbajtësit të familjes të jetë llogaritur sipas dispozitave ligjore në fuqi deri në 31.12.2014.

10. Shuma bazë e pensionit e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit nr. 32, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim të jetë 7 843 (shtatë mijë e tetëqind e dyzet e tre) lekë.

11. Miratimin e indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2019 me indeksin 2,8 % të llogaritur sipas kritereve të përcaktuara në nenin 59, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Indeksi i sipërshtuar të aplikohet për rivlerësimin e bazës së vlerësuar të arritur deri në vitin 2019, për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensionit që do të caktohet me datë fillimi pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim. Pas aplikimit të tij, baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensionit që do të caktohet me datë fillimi pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk mund të jetë më e lartë se:

a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, prej 30 000 lekësh, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1025, datë 16.12.2020, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, për pagat e periudhës nga viti 1994 deri në 31.12.2001;

b) paga maksimale në shkallë vendi prej 130 312 lekësh, e përcaktuar sipas kritereve të paragrafit të

fundit të nenit 10, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

12. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përlllogariten në shumën 2 400 000 000 (dy miliard e katërqind milionë) lekë, përballohen nga fondi për politikat e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e ISSH-së të vitit 2021 të cilat ndahen:

a) 2 385 000 000 (dy miliardë treqind e tetëdhjetë e pesë milionë) lekë, për mbulimin e pagesave të përfitimeve;

b) 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a., dhe bankat e nivelit të dytë;

13. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i cili brenda një muaji nga data e miratimit të tij, të hartojë dhe të dërgojë për botim në “Fletoren zyrtare” tabelën e koeficientëve progresivë të indeksimit të bazës së vlerësuar të arritur nëpërmjet kontributeve të derdhura për periudhën kontributive deri në vitin 2021, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.4.2021.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe

**VENDIM**  
Nr. 211, datë 31.3.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E SUPERVIZIMIT E TË KOLAUDIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË KAMZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e



Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 14 820 655 (katërmëdhjetë milionë e tetëqind e njëzet mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e supervizimit e të kolaudimit të rindërtimit dhe rikonstruksionit të 9 (nëntë) objekteve arsimore, si dhe të rihartimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) të ndara me lote, në Bashkinë Kamzë.

2. Efekti financiar sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe

**VENDIM**  
Nr. 213, datë 31.3.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 775, DATË 30.9.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT NGA BASHKIA DURRËS, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E HARTIMIT TË PROJEKTPREVENTIVIT DHE RIFORCIMIT E HIDROVORIT TË DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e

Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 775, datë 30.9.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për hartimin e studimprojektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 88 128 502 (tetëdhjetë e tetë milionë e njëqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e dy) lekë pa TVSH, për hartimin e studimprojektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, të detajuar, si më poshtë vijon:

a) për vitin 2020, në masën 51 550 000 (pesëdhjetë e një milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH;

b) për vitin 2021, në masën 36 578 502 (tridhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dy) lekë pa TVSH.”.

3. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit dhe i transferohet Bashkisë Durrës, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për hartimin e studimprojektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit.”.

II. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Erion Braçe



**VENDIM**  
**Nr. 215, datë 31.3.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË  
 RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E  
 RINDËRTIMIT TË BANESAVE  
 INDIVIDUALE, NË BASHKITË LEZHË  
 DHE KURBIN, DHE CAKTIMIN E TYRE  
 SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 716 338 013 (shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e tetë mijë e trembëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, në bashkitë Lezhë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi, në masën 89 175 467 (tetëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e 42 (dyzet e dy) njësive individuale të banimit;

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 627 162 546 (gjashtëqind e njëzet e shtatë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e 225 (dyqind e njëzet e pesë) njësive individuale të banimit.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit për vitin 2021, në masën 143 267 602 (njëqind e dyzet e tre milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dy) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit. të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e

para, në bashkitë Lezhë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi, në masën 17 835 093 (shtatëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 125 432 509 (njëqind e njëzet e pesë milionë e katërqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e nëntë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Caktimin si njësi zbatuese të bashkive Lezhë dhe Kurbin për rindërtimin e njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Lezhë e Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

**UDHËZIM**  
**Nr. 6, datë 31.3.2021**

**PËR ZHVILLIMIN E VLERËSIMIT TË  
 ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË  
 ARSIMIT FILLOR, VITI SHKOLLOR  
 2020–2021**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 dhe të nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor më datë 21 maj 2021, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta.

2. Testi është i integruar dhe përfshin lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.

3. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, fillon në orën 10:00 dhe zgjat 1 orë e 30 minuta.





4. Nxënësi duhet të paraqitet 1 (një) orë përpara në qendrën ku zhvillohet testi.

5. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor”, miratuar me urdhrin nr. 78, datë 27.2.2020.

6. Nxënësit me aftësi të kufizuara e zhvillojnë vlerësimin e arritjeve bazuar në planin edukativ individual me të cilin punojnë dhe në përshtatje me veçoritë e tyre.

7. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), një ditë para zhvillimit të vlerësimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit *Brail*.

8. Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) monitoron procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur gjatë zhvillimit të tij.

9. Arkivimi i testeve bëhet pranë Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP).

10. ZVAP-ja merr nga Qendra e Vlerësimit të Testit dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku është realizuar vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor. Këto të dhëna dërgohen në QSHA, në DPAP dhe në Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.

11. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT  
DHE RINISË  
**Evis Kushi**

## UDHËZIM

Nr. 7, datë 31.3.2021

### **PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020 “PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 30 dhe 35, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre” dhe vendimit nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i asociuar’ dhe ‘Profesor’”, i ndryshuar,

## UDHËZOJ:

1. Germa “E” e kreut IV të udhëzimit nr. 1, datë 14.1.2020, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“E. “DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR HAPJEN/RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”

1. LAL-ja ngarkon në platformën e-Albania, sipas formularit përkatës në platformën e-Albania, mbështetur në shtojcën nr. 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij, aplikimin për hapjen/riorganizimin e programit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore



“Doktor”, brenda datës 30 shtator për vitin akademik pasardhës.

2. MASR-ja, brenda një afati 60-ditor nga data e aplikimit njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.

3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR-ja, IAL-ja, brenda 15 ditëve, ngarkon elektronikisht dokumentacionin e mëposhtëm:

a) propozimin e njësive bazë ku do të ofrohet programi i studimit;

b) projektin kërkimor-shkencor dhe zhvillimit;

c) vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton hapjen/riorganizimin e programit/eve të studimit. Në rast se propozimi vjen nga një institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkon financim nga buxheti i shtetit depozitohet miratimi paraprak i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL). Në rast financimi nga vetë IAL-ja, në vendimin e Bordit të Administrimit të IAL-së duhet të jetë e shprehur qartësisht që masa e financimit të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit do të mbulohet nga të ardhurat e IAL-së dhe nuk do të kërkohej financim shtesë nga buxheti i shtetit (për IAL-të publike).

Aktin e miratimit të financimit të projekteve kërkimore-shkencore nga AKKSHI-ja (në rast se ka);

d) mandatpagesën për tarifën që paguhet për vlerësimin paraprak nga ekspertët e jashtëm të caktuar sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar;

e) dokumentin e grupimit të njësive bazë (akt marrëveshje/akt i organeve kolegjiale, për grupimin e departamenteve/qendrave kërkimore-shkencore) në institucionin e arsimit të lartë, në rast grupimi sipas fushave e nënfushave, të ngjashme ose të përafërta, referuar standardeve ndërkombëtare të përcaktuara në propozimin e programit (IAL-të mund t’u referohen nënfushave të parashikuara në Manualin e FRASCAT-it, ISCED etj.);

f) deklaram për kapacitetet infrastrukturore, si vijon:

i. lista e laboratorëve shkencorë të akredituar ose jo;

ii. lista e bibliotekave të profilizuara dhe kapaciteti fizik i tyre, i shprehur në vende/poste pune kërkimi;

iii. lista e arkivave dhe e koleksioneve shkencore;

iv. lista e abonimeve në revista apo e botimeve shkencore periodike, përshtirë dhe ato elektronike;

g) deklaram për kapacitetet akademike, si vijon:

i. lista e personelit akademik të njësive bazë apo grupimit të njësive sipas fushave, i kategorisë “Profesor”, në momentin e paraqitjes së aplikimit, dëshmitë e titujve akademike dhe kontratat e punës;

ii. letërangazhimin e personelit akademik me tituj, të njësive bazë, si drejtues shkencor për udhëheqjen e doktorantëve për programet e studimit të doktoratës;

h) rregullore e programit të studimeve të doktoratës, e cila përfshin planin e programit të studimit të doktoratës. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese;

j) në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër vendas ose të huaj të arsimit të lartë për hapjen/riorganizimin e programeve të përbashkëta të studimit të doktoratës, së bashku me dokumentacionin e mësipërm, kërkohet depozitimi në gjuhë shqipe, i përkthyer dhe njëshuar me origjinalin të dokumenteve si më poshtë:

i. akti i akreditimit të institucionit partner;

ii. dokumenti zyrtar i bashkëpunimit (marrëveshje kuadër), ku parashikohet ofrimi i programeve të përbashkëta të studimit;

iii. marrëveshja specifike për programin konkret të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij;

iv. lloji dhe modeli i diplomës i miratuar nga IAL-të.

4. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për hapjen/riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore “Doktor”:

a) shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të mësipërm realizohet në MASR, brenda 21 ditëve nga depozitimi. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR-ja i kërkon IAL-së që të bëjë plotësimin/saktësimin e dokumentacionit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Në mungesë të plotësimit të dokumentacionit brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet.



b) në rast se dokumentacioni konsiderohet i plotë, dokumentacioni i kalon për vlerësim ekspertëve të caktuar nga MASR-ja, sipas fushave të ekspertizës dhe të zgjedhur nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar nga ASCAL-ja, të caktuar me urdhër të ministrit. Ekspertët, brenda 21 ditëve, dorëzojnë raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni vlerësohet nga ekspertët se është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, institucionit i kërkohet plotësimi i tij brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit. Në mungesë të plotësimit të dokumentacionit, brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

c) dokumentacioni i plotësuar i kalon për rivlerësim ekspertëve, të cilët, brenda 15 ditëve, dorëzojnë raportin e rivlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë, praktika arkivohet;

d) pas vlerësimit përfundimtar pozitiv nga ekspertët, ministri miraton me urdhër hapjen/riorganizimin e programit të studimit.

2. Pas kreut IV/E, shtohet kreu IV/F me këtë përmbajtje:

**“F. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR VERIFIKIMIN E KAPACITETEVE AKADEMIKE DHE INFRASTRUKTURE PAS MIRATIMIT PËR HAPJEN/RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”.**

1. Një vit pas hyrjes në fuqi të aktit të hapjes/riorganizimit së programit të studimit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, IAL-ja dërgon zyrtarisht në MASR aplikimin, së bashku me dokumentacionin shoqërues, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij, për verifikimin e kapaciteteve, 3 (tre) muaj kalendarikë, përpara fillimit të vitit akademik përkatës, për certifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për këtë program studimi nga ana e MASR-së.

Informacioni i kërkuar mbi bazën e formularit të aplikimit është si më poshtë:

a) vendimin e Senatit Akademik për përcaktimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për

programet e studimit të ciklit të tretë, për fitimin e gradës shkencore “Doktor”;

b) listën e projekteve kërkimore-shkencore dhe zhvillimit që ndjek njësia bazë;

c) numrin dhe listën e personelit akademik të përfshirë në këto projekte dhe sipas studentëve doktorantë, sipas përcaktimeve të nenit 65, të ligjit nr. 80/2015;

d) ndryshimet në kapacitetet akademike dhe infrastrukturore për përfshirjen në programet e studimit të doktoratës që nga momenti i hapjes/riorganizimit të programit;

e) si dhe çdo të dhënë/dokument të përcaktuar në shtojcën nr. 4 të udhëzimit.

2. Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për certifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore pas hapjes/riorganizimit të programeve të studimit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore “Doktor”:

a) MASR-ja shqyrton dokumentacionin për verifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore mbi bazën e informacionit të paraqitur nga IAL, për kapacitetet infrastrukturore të vënë në dispozicion të projektit dhe kapaciteteve të personelit akademik të përfshira në projektin përkatës;

b) MASR-ja shqyrton kërkesën brenda 30 ditëve dhe certifikon këto kapacitete, nëse janë në përputhje me standardet shtetërore.

3. Në kreun VI, pika 5.4 të ndryshojë si më poshtë:

“Përfundimisht, aplikimet për programet e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” për vitin akademik 2021–2022, do të pranohen deri më 30 prill 2021.”.

4. Pas shtojcës nr. 2, shtohen shtojcat nr. 3 dhe nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT  
DHE RINISË  
**Evis Kushi**



SHTOJCË NR. 3  
 MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
 PROPOZIMI PËR HAPJEN/RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT  
 TË TRETË PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”

1. Institucioni /IAL	2. Aplikimi (zgjidh një): Program i ri _____ Riorganizim programi _____
3. Emërtimi i programit të propozuar për hapje/riorganizim <b>Fusha kryesore e kërkimit:</b> _____ <b>Nënfusha sipas standardeve ndërkombëtare të kërkimit/shkenca:</b> Doktoratë në: “ _____ ”	
4. Viti akademik i hapjes (në rast të aplikimit për riorganizimin e programit të studimit)	
5. a) Të dhënat për aktin e hapjes/riorganizimit / akreditimit të IAL dhe/ ose njësisë kryesore që ofron programin e studimit b) Të dhëna për aktet e hapjes/riorganizimit/akreditimit të programeve të cikleve të parë dhe të dytë në fushën e studimit të programit të doktoratës	6. Vendimi i miratimit nga Senati Akademik Nr. _____, datë _____ Vendimi i miratimit nga Bordi i Administrimit nr. _____, datë _____
7. Nëse është një program i përbashkët, cito aktin e bashkëpunimit ndërmjet IAL-ve dhe marrëveshjen specifike për realizimin e programeve të studimit të doktoratës.	
8. Organizimi i programit: - Programi ofrohet nga një njësi bazë/ grupimi i njësisë: Njësia/të bazë _____ Njësia kryesore _____ Kampusi/ godina _____ - <b>Program i përbashkët i ofruar nga disa njësi bazë:</b> Njësia/njësitë bazë _____ Njësia/të kryesore _____ Kampusi/ godina _____	
9. Të dhënat për koordinatorin e doktoratës: <b>1. Emër, mbiemër:</b> Pozicioni në IAL: Tel: E-mail:	
10. Deklaratë e titullarit të IAL-së për plotësimin e standardeve akademike dhe infrastrukture, të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
11. Firma (emër, mbiemër) e titullarit të institucionit dhe vula e institucionit.  <p style="text-align: center;"><b>REKTORI</b> Prof.dr. _____</p> <p>Data _____ Firma, vula _____</p>	



PËRSHKRIMI I PROGRAMIT KËRKIMOR-SHKENCOR DHE ZHVILLIMIT TË  
STUDIMEVE TË DOKTORATËS PËR HAPJE/RIORGANIZIM

Institucioni i arsimit të lartë: Universiteti/Akademia \_\_\_\_\_

I. TË DHËNA MBI PROGRAMIN ZHVILLIMOR STUDIMEVE TË DOKTORATËS

**Të dhëna të përgjithshme**

Emërtimi i programit të studimeve të doktoratës	Doktoratë në fushën/nënfusha sipas standardeve ndërkombëtare
Cikli i studimeve:	Cikli i tretë
Lloji i programit:	Doktoratë
Njësia bazë	
Njësia kryesore	
Studimi me kohë normale, shprehur në vite:	3-5
Studimi kohë të zgjatur, shprehur në vite:	5
Gjuha e studimit:	

II. TË DHËNA TË DETAJUARA TË PROGRAMIT ZHVILLIMOR TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS

**1. Përshkrimi**

Informacion i detajuar rreth programit:

- argumentimi pse duhet të hapet/riorganizohet;
- përshkrimi i kontekstit të fushës së kërkimit shkencor;
- të argumentohet rëndësia e fushave të kërkimit me nevojat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- të pasqyrohen të dhënat për burimet e veçanta që ka institucioni;
- të pasqyrohen të dhënat për kapacitetet maksimale pritëse për këtë program;
- përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të programit;
- analiza SWOT e aplikimit për hapjen/riorganizimit e programit të studimit.

**2. Të dhëna mbi kriteret e pranimit në këtë program, tarifa dhe modalitete financiare:**

- Kriteret e pranimit në programin e studimit.
- Kostoja e studimeve të doktoratës dhe tarifa e studimit të përcaktuar me vendim të Bordit të Administrimit.
- Politika e mbështetjes financiare për doktorantët nëse ka.

**3. Elementet e planit vjetor të programit të studimit të doktoratës bazuar në projektin kërkimor-shkencor dhe zhvillimit të financuar të njësisë bazë**

a) Koha e realizimit të veprimtarive të kombinuara, kur programet e studimit të doktoratës zhvillohen me kohë të plotë, sipas kohëzgjatjes normale të studimit nga 3 deri në 5 vite, bëhet sipas planit doktoral të miratuar nga njësia bazë përgjegjëse.



b) Koha e realizimit të veprimtarive të kombinuara, kur programet e studimit të doktoratës zhvillohen me kohë të zgjatur, sipas kohëzgjatjes normale të studimit 5 vite, bëhet sipas planit doktoratë të miratuar nga njësia bazë.

#### 4. Personeli akademik për realizimin e programit

Numri total i personelit akademik të angazhuar \_\_\_\_.

Numri total i personelit akademik të angazhuar. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar” dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë dhe të respektojnë përcaktimet e nenit 65, të ligjit nr. 80/2015. Ky numër përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë “Profesor” ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar.

Nr.	Personeli akademik	Titulli akademik dhe fusha e ekspertizës (prof./prof. as.) gradë shkencore në:	Institucioni	Njësia/ grupi i njësive bazë	Lloji i angazhimit
1					
2					
3					

#### 5. Programet e përbashkëta

Ky seksion plotësohet vetëm nëse programi i propozuar ofrohet në bashkëpunim me një institucion tjetër duke përfshirë edhe një përshkrim të nivelit të bashkëpunimit, duke iu përgjigjur elementeve të mëposhtme:

- Burimet financiare dhe kontributi i partnerëve.
- Vënia në dispozicion e burimeve nga partnerët.
- Administrimi i programit.
- Modeli dhe lloji i diplomës (diplomë e përbashkët/e dyfishtë/e shumëfishtë).
- Të dhëna mbi aktin e themelimit/licencimit të institucionit partner në vendin e origjinës.
- Të dhëna mbi aktin e akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit.
- Dokument zyrtar bashkëpunimi mes palëve, marrëveshja kuadër.
- Marrëveshja specifike për programin konkret të studimit.

#### 6. Analizë e prioriteteve të kërkimit shkencor

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementet e mëposhtme:

- Argumentim i nevojës të hulumtimit, kërkimit shkencor, inovacionit, të thelluar në këtë fushë.
- Marrëveshje me institucione publike dhe jopublike të cilat mund të asistojnë kërkimin shkencor.



SHTOJCË NR. 4  
 MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
 APLIKIM PËR VERIFIKIMIN E KAPACITETEVE AKADEMIKE DHE  
 INFRASTRUKTURE, PAS HAPJES/RIORGANIZIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË  
 DOKTORATËS “\_\_\_\_\_”

1. Institucioni /IAL	Program i studimit doktoratë në _____,
2. Viti akademik i aktivizimit të programit dhe numri i doktorantëve të regjistruar sipas viteve akademike (detajuar me kohë të plotë dhe me kohë të zgjatur).	
3. Fusha kryesore e kërkimit: _____ Nënfusha e kërkimit: Doktoratë në “_____”	
4. Të dhëna nëse programi ka financim nga AKKSHI apo institucioneve të tjera financuese.	
5. Të dhënat për aktin e hapjes/akreditimit të IAL dhe të programit e studimit	6. Listën e projekteve/projektet kërkimore-shkencore dhe zhvillimit që zhvillohen nga njësi bazë, mbi bazë të së cilës janë ndërtuar projektet individuale të doktorantëve 7. Përcaktimi i numrit të studentëve doktorantë nga njësi bazë për vitin akademik respektiv 8. Të dhëna mbi vendimin e Senatit Akademik për numrin e projekteve të doktoratës të iniciuar nga IAL-ja dhe numrin e studentëve të përfshirë në to dhe atyre që do të përfshihen.
9. Nëse është një program i përbashkët, cito aktin e bashkëpunimit ndërmjet IAL-ve dhe marrëveshjen specifike për realizimin e programeve të studimit të doktoratës dhe për përcaktimin e numrit të doktorantëve	
10. Organizimi i programit: - Programi ofrohet nga: Njësi bazë _____ Njësi kryesore _____ Kampusi/ godina _____ <b>- Program i përbashkët i ofruar nga disa njësi bazë:</b> Njësi/njësitë bazë _____ Njësi kryesore _____ Kampusi/ godina _____	
11. Të dhënat për koordinatorin e doktoratës: Emër, mbiemër: Pozicioni në IAL: Tel: E-mail:	
12. Deklaratë e titullarit të IAL-së për plotësimin e standardeve akademike dhe infrastrukturore, të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
13. Firma (emër, mbiemër) e titullarit të institucionit dhe vula e institucionit.  <div style="text-align: center;"> <b>REKTORI</b>            Prof.dr. _____         </div> Data _____ Firma, vula _____	



## TË DHËNA MBI PROGRAMIN E STUDIMEVE TË DOKTORATËS

### 1. Të dhëna të përgjithshme:

Emërtimi i programit të studimeve të doktoratës	Doktoratë në fushën/nënfisha sipas standardeve ndërkombëtare
Cikli i studimeve:	Cikli i tretë
Lloji i programit:	Doktoratë
Njësia bazë	
Njësia kryesore	
Studimi me kohë të plotë, shprehur në vite:	3-5
Studimi kohë të zgjatur, shprehur në vite:	5
Gjuha e studimit:	
Numri i studentëve aktiv në këtë program studimi, sipas viteve akademike:	

### 2. Të dhëna mbi kostot, tarifa dhe modalitete financiare:

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kostoja e studimeve të doktoratës dhe tarifa e studimit të përcaktuar me vendim të Bordit të Administrimit.</li> <li>- Politika e mbështetjes financiare për doktorantët nëse ka.</li> <li>- Lista e projekteve individuale.</li> </ul>
--

### 3. Personeli akademik i angazhuar për realizimin e programit.

Numri total i personelit akademik të angazhuar. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar” dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë dhe të respektojnë përcaktimet e nenit 65, të ligjit nr. 80/2015. Ky numër përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë “Profesor” ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar.

Për ndryshimet në personelin akademik, IAL dërgon kopje të dëshmisë për fitimin e titullit, diplomës së gradës shkencore dhe kontratën e punës.

Të jepen të dhëna për ndryshimet në kapacitetet akademike dhe infrastrukturore për përfshirjen në programin e doktoratave që nga momenti i hapjes/riorganizimit të programit.

Në tabelë duhet të evidentohen numri dhe lista e personelit akademik të përfshirë në projektet e reja individuale sipas numrit të studentëve të miratuar.

Nr.	Personeli akademik	Titulli akademik dhe fusha e ekspertizës (prof./prof. as.) gradë shkencore në:	Institucioni	Njësia bazë ose grupimi i njësive sipas fushave	Lloji i angazhimit	Numri i doktorantëve që udhëheq
1						
2						
3						





#### 4. Programet e përbashkëta

Ky seksion plotësohet vetëm nëse programi i propozuar ofrohet në bashkëpunim me një institucion tjetër duke përfshirë edhe një përshkrim të nivelit të bashkëpunimit, duke iu përgjigjur elementeve të mëposhtme:

- Burimet financiare dhe kontributi i partnerëve për vitin akademik respektiv.
- Vënia në dispozicion e burimeve nga partnerët.
- Administrimi i programit.
- Marrëveshja specifike për përcaktimin e numrit të doktorantëve për vitin akademik.

#### 5. Deklarim për kapacitetet infrastrukturore për zhvillimin e programit të studimit

(Në këtë rubrikë evidentohen në mënyrë narrative ndryshimet në kapacitete)

Lista e laboratorëve shkencorë të akredituar ose jo	
Lista e bibliotekave të profilizuara dhe kapaciteti fizik i tyre, i shprehur në vende/poste pune kërkimi	
Lista e arkivave dhe e koleksioneve shkencore	
Lista e abonimeve në revista apo e botimeve shkencore periodike, përfshirë dhe ato elektronike	

#### 6. Të dhëna mbi institucionet bashkëpunuese ku kryhet kërkimi shkencor i doktorantëve

##### URDHËR

Nr. 191, datë 29.3.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E SHUMËS  
MINIMALE TË MBULIMIT ME SIGURIM  
PËR NJË NGJARJE TË SIGURUAR DHE  
SHUMËS MINIMALE TË TËRËSISË SË  
DËMSPËRBLIMEVE NGA SIGURIMI,  
QË JANË TË PAGUESHME GJATË VITIT  
TË SIGURIMIT PËR NJË APO MË  
SHUMË NGJARJE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 65, pika 6, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”,

##### URDHËROJ:

1. Shuma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar dhe shuma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje, përcaktohet çdo vit, në bazë të mesatares së vëllimit të punës së veprimtarisë noteriale për 3 (tri) vitet e fundit, për çdo noter, e përllogaritur nga numrat e koleksionit, si më poshtë:

a) nga 1 deri në 1000 numra koleksioni, shuma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar është 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë dhe shuma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje është 18 000 000 (tetëmbëdhjetë milionë) lekë;

b) nga 1001 deri në 3000 numra koleksioni, shuma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar është 18 000 000 (tetëmbëdhjetë milionë) lekë dhe shuma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje është 54 000 000 (pesëdhjetë e katër milionë) lekë;

c) nga 3001 deri në 5000 numra koleksioni, shuma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar është 25 000 000 lekë (njëzet e pesë milionë) dhe shuma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më shumë ngjarje është 75 000 000 (shtatëdhjetë e pesë milionë) lekë;

ç) mbi 5001 numra koleksioni, shuma minimale e mbulimit me sigurim për një ngjarje të siguruar është 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekë dhe shuma minimale e tërësisë së dëmshpërblimeve nga sigurimi, që janë të pagueshme gjatë vitit të sigurimit për një apo më



shumë ngjarje është 105 000 000 (njëqind e pesë milionë) lekë.

2. Në rast se Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Kombëtare të Noterisë vendos që sigurimi kolektiv të jetë i detyrueshëm për të gjithë noterët ose, në rast se Dhoma Kombëtare e Noterisë kontraktin, përzgjedh dhe lidh një kontratë kolektive sigurimi për një grup noterësh, përllogaritja e vlerës përkatëse të primit të sigurimit për çdo noter, kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në pikën 1 të këtij urdhri.

3. Çdo noter është i detyruar që jo më pak se 15 ditë përpara lidhjes së kontratës së sigurimit të përllogaritë dhe të njoftojë Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë për mesataren e numrave të koleksionit, duke u bazuar në të dhënat që administrohen nga sistemi elektronik dhe nga regjistrat noterialë që mbahen në çdo zyrë noterialë.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË  
Etilda Gjonaj (Saliu)

KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM  
TË SHPRONËSIMEVE  
Erlis Hereni

## KËRKESË

Nr. 50/3, datë 31.3.2021

### PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtim rruga Porto-Romano – Durrës, loti 3”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “tokë arë” dhe “truall”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 47 801 548 (dyzetë e shtatë milionë e tetëqind e një mijë e pesëqind e dyzetë e tetë) lekë.

### Lista emërore paraprake për pasuritë e paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim rruga Porto-Romano – Durrës, loti 3”

Nr.	Pronari			Zona kad.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pas.	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi lek/(m <sup>2</sup> )	Vlera (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Shtet			8517	327/1	3800	Kanal	209	0	-	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Shtet			8517	327/2	3040	Rrugë	209	0	-	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Shtet			8517	332/1	15300	Rrugë	156	0	-	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	Shtet			8517	332/2	30600	Kanal	530	0	-	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	Shtet			8517	47	141000	Arë	11357	420	4,769,940	Kufizuar nga ASHK
6	Shtet			8517	48	140250	Arë	7120	420	2,990,400	Kufizuar nga ASHK-ja
7	Shtet			8517	49	146375	Arë	8061	420	3,385,620	Kufizohet nga ASHK-ja
8	Shtet			8517	50	135000	Arë	1458	420	612,360	Kufizohet sipas shkresës së ASHK-së
9	Shtet			8517	35	67780	Arë	14983	420	6,292,860	Kufizohet sipas shkresës së ASHK-së
10	Rrahman		Elezi	8517	22/6	6877	Arë	2765	420	1,161,300	Konfirmuar nga ASHK-ja
11	Rrahman		Iseberi	8517	22/4	9106	Arë	2890	420	1,213,800	Konfirmuar nga ASHK-ja
12	Elmaz		Iseberi	8517	22/3	8106	Arë	2908	420	1,221,360	Konfirmuar nga ASHK-ja
13	Dritan		Isberi	8517	22/2	3000	Arë	233	420	97,860	Konfirmuar nga ASHK-ja
14	Bajram		Iseberi	8517	22/1	5505	Arë	1961	420	823,620	Kufizohet nga ASHK-ja
15		Suzana Miftari		8517	6/10	4000	Arë	848	420	356,160	Kufizuar
16		Luljeta Perfundit		8517	6/9	4000	Arë	1057	420	443,940	Kufizuar
17	Vivjana		Luca	8517	6/13	4000	Arë	927	420	389,340	Konfirmuar nga ASHK-ja
18	Tana	Vasil	Ziu	8517	6/7	4000	Arë	962	420	404,040	Konfirmuar nga ASHK-ja
19	Tol		Ziu	8517	6/6	5750	Arë	1325	420	556,500	Konfirmuar nga ASHK-ja
20	Djana		Gjoka	8517	6/5	4153	Arë	946	420	397,320	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Vangjel		Kajan								
21	Shtet			8517	6/4	2077	Arë	416	420	174,720	Konfirmuar nga ASHK-ja
22	Bardhyl		Kabli	8517	6/3	4000	Arë	965	420	405,300	Konfirmuar nga ASHK-ja



23	Musa	Vora	8517	6/2	3000	Arë	683	420	286,860	Konfirmuar nga ASHK-ja	
24	Zef	Macorri	8517	6/1	20000	Arë	4533	420	1,903,860	Konfirmuar nga ASHK-ja	
25	Mmyre	Puja	8517	38/17	10000	Arë	1021	420	428,820	Konfirmuar nga ASHK-ja	
26	Shahin	Peposhi	8517	38/16	10400	Arë	1204	420	505,680	Konfirmuar nga ASHK-ja	
27	Dashnor	Bardhoci	8517	38/15	1000	Arë	117	420	49,140	Konfirmuar nga ASHK-ja	
28	shtet		8517	38/14		Arë	94	420	39,480	Konfirmuar nga ASHK-ja	
29	Sulejman	Bardhoci	8517	38/13	1000	Arë	117	420	49,140	Konfirmuar nga ASHK-ja	
30	Qemal	Bardhoci	8517	38/12	1000	Arë	89	420	37,380	Konfirmuar nga ASHK-ja	
31	Hajzi	Bardhoci	8517	38/11	3900	Arë	420	420	176,400	Konfirmuar nga ASHK-ja	
32	Shtet		8517	38/22	2400		262	420	110,040	Konfirmuar nga ASHK-ja	
33	Xhevaire	Brahaj	8517	38/8	500	Arë	95	420	39,900	Konfirmuar nga ASHK-ja	
34	Rexhep	Braha	8517	38/7	1500	Arë	123	420	51,660	Konfirmuar nga ASHK-ja	
35	Nexhmije	Brahaj	8517	38/6	1500	Arë	157	420	65,940	Konfirmuar nga ASHK-ja	
36	Elez	Brahaj	8517	38/5	450	Arë	79	420	33,180	Konfirmuar nga ASHK-ja	
37	Mus	Brano	8517	38/4	5200	Arë	580	420	243,600	Konfirmuar nga ASHK-ja	
38	Gani	Istrefi	8517	38/1	5200	Arë	806	420	338,520	Konfirmuar nga ASHK-ja	
39	Besnik	Xhavit	Tusha	8517	5/4	20000	Arë	7382	420	3,100,440	Kufizuar nga ASHK-ja
40	Çezarina	Çezar	Larushi	8517	3/1	4000	Arë	876	420	367,920	Konfirmuar nga ASHK-ja
41	Adriatik	Haxhij	8517	2/223	5000	Truall	1327	3119	4,138,913	Konfirmuar nga ASHK-ja	
42	Shtet		8517	2/3	9824	Moçalish te	2660	0	-	Konfirmuar nga ASHK-ja	
43	Shtet		8517	2/2	4770	Arë	2810	420	1,180,200	Okupuar	
44	Aldoch Farma Sh.p.k		8517	2/221	5000	Truall	1821	3119	5,679,699	Vihet në favor të Credins Bank	
45	Halil	Dida	8517	38/30	1800	Arë	1065	420	447,300	Konfirmuar nga ASHK-ja	
46	Shtet		8517	38/31		Arë	1314	420	551,880	Konfirmuar nga ASHK-ja	
47	Shoqëria Tregtare Shqiptare “Ndërtim dhe konstruksione”		3184	63/107	1000	Arë	81	554	44,874	Konfirmuar nga ASHK-ja	
48	Besnik	Brahaj	3184	71/21	2600	Arë	316	554	175,064	Konfirmuar nga ASHK-ja	
49	Hamdi	Elezi	3184	71/24	3670	Arë	324	554	179,496	Konfirmuar nga ASHK-ja	
50	Osman	Elezi	3184	71/15	7540	Arë	831	554	460,374	Konfirmuar nga ASHK-ja	
51	Osman	Elezi	3184	71/23	3770	Arë	326	554	180,604	Konfirmuar nga ASHK-ja	
52	Nexhit	Voka	3184	71/6	1690	Arë	194	554	107,476	Konfirmuar nga ASHK-ja	
53	Sali, Kade	Voka	3184	71/1	9096	Arë	589	554	326,306	Vihet në favor të shoq. Anonime Kastriot Petrol	
54	Shkelqim	Shahini	3184	63/110	1000	Arë	73	554	40,442	Konfirmuar nga ASHK-ja	
55	Gjergj	Sheno	3184	63/32	1000	Arë	23	554	12,742	Konfirmuar nga ASHK-ja	
56	Gjergj	Sheno	3184	63/33	1000	Arë	26	554	14,404	Konfirmuar nga ASHK-ja	
57	Gjergj	Sheno	3184	63/34	1000	Arë	20	554	11,080	Konfirmuar nga ASHK-ja	
58	Arben	Kokomani	3184	63/35	1000	Arë	25	554	13,850	Konfirmuar nga ASHK-ja	
59	Gjergj	Sheno	3184	63/38	1000	Arë	28	554	15,512	Konfirmuar nga ASHK-ja	
60	Gjergj	Sheno	3184	63/39	1000	Arë	26	554	14,404	Konfirmuar nga ASHK-ja	
61	Arben	Kokomani	3184	63/40	1000	Arë	28	554	15,512	Konfirmuar nga ASHK-ja	
62	Gjergji	Sheno	3184	63/41	1000	Arë	23	554	12,742	Konfirmuar nga ASHK-ja	
63	Gjergji	Sheno	3184	63/43	1000	Arë	28	554	15,512	Konfirmuar nga ASHK-ja	
64	Jak	Musteqja	3184	63/64	1000	Arë	46	554	25,484	Konfirmuar nga ASHK-ja	
65	Pieter	Musteqja	3184	63/66	1000	Arë	50	554	27,700	Konfirmuar nga ASHK-ja	
66	Mark	Musteqja	3184	63/65	1000	Arë	44	554	24,376	Konfirmuar nga ASHK-ja	
67	Gjergji	Sheno	3184	63/42	1000	Arë	31	554	17,174	Konfirmuar nga ASHK-ja	
68	Naim	Elezi	3184	63/36	1000	Arë	25	554	13,850	Konfirmuar nga ASHK-ja	
69	Gjergj	Sheno	3184	63/31	1000	Arë	23	554	12,742	Kufizohet	
70	Gjergj	Sheno	3184	63/29	1000	Arë	21	554	11,634	Kufizohet	
71	Gjergj	Sheno	3184	63/28	1000	Arë	18	554	9,972	Kufizohet	
72	Naim	Elezi	3184	63/121	2004	Arë	51	554	28,254	Kufizohet	
73	Arben	Kokomani	3184	63/120	2004	Arë	44	554	24,376	Konfirmuar nga ASHK-ja	
74	Gjergj	Sheno	3184	63/27	1000	Arë	20	554	11,080	Kufizohet	
75	Selam	Gjocaj	3184	63/26	1002	Arë	21	554	11,634	Konfirmuar nga ASHK-ja	
76	Raiffeisen Bank sh.a.		3184	63/115	22546	Arë	699	554	387,246	Kufizohet	
77	Alush	Thaci	3184	63/30	3000	Arë	60	554	33,240	Konfirmuar nga ASHK-ja	
<b>Shuma paraprake</b>									<b>47,801,548</b>		

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë